

20141304101

LIGJ PËR THEMELIM TË KOMISIONIT SHTETËROR PËR VENDIMMARRJE NË SHKALLË TË DYTË NË SFERËN E MBIKËQYRJES INSPEKTUESE DHE PROCEDURËS KUNDËRVAJTËSE

Neni 1

(1) Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Shkallë të Dytë në Sferën e Mbikëqyrjes Inspektuese dhe Procedurës Kundërvajtëse (në tekstin e mëtejme: Komisioni Shtetëror) është kompetent për zgjidhjen e ankesave kundër aktvendimeve të miratuara në shkallë të parë në procedurë inspektuese si dhe për ankesa kundër vendimeve për kundërvajtje që janë miratuar nga organi kundërvajtës, kur me ligj është përcaktuar të vendosin në procedurë kundërvajtëse.

(2) Në procedurën për vendosje për ankesa Komisioni Shtetëror i zbaton dispozitat nga Ligji për procedurë të përgjithshme administrative, Ligji për mbikëqyrje inspektuese dhe Ligji për kundërvajtje nëse me këtë ose me ligj tjetër nuk është rregulluar ndryshe.

Neni 2

(1) Komisioni Shtetëror është organ shtetëror i cili është i pavarur në punën e tij dhe ka cilësinë e personit juridik.

(2) Komisioni Shtetëror ka shërbim profesional. Për të punësuarit në shërbimin profesional zbatohen dispozitat nga ligji me të cilin rregullohen të drejtat dhe obligimet e nëpunësve administrativë.

(3) Komisioni Shtetëror financohet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 3

(1) Komisioni Shtetëror përbëhet nga kryetari dhe gjashtë anëtarë të cilët funksionin e kryejë profesionalisht.

(2) Kryetarët dhe anëtarët e Komisionit Shtetëror i zgjedh nëpërmjet konkursit publik dhe i shkarkon Kuvendi i Republikës së Maqedonisë me propozim të Komisionit për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

(3) Kryetari dhe anëtarët e Komisionit Shtetëror zgjidhen në periudhë prej pesë vitesh me të drejtë të zgjedhjes së sërishme.

(4) Kryetar i Komisionit Shtetëror zgjidhet person i cili:

- është shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- në momentin e zgjedhjes me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës, ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- ka marrë së paku 300 kredi sipas SETK ose ka mbaruar shkallën VII/1 fakultetin juridik;
- ka së paku gjashtë vjet përvojë pune në punët administrative;
- posedon një nga certifikatat e pranuara ndërkombëtarisht ose vërtetim për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:

1. TOEFEL IBT- së paku 74 pikë,
2. IELTS (IELTS)- së paku 6 pikë,
3. ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal)- së paku nivelin B2 (B2),
4. FCE (FCE) (Cambridge English: First)- të kaluar,
5. BULATS (BULATS) - së paku 60 pikë ose
6. APTIS (APTIS) - së paku nivelin B2 (B2) dhe të ketë kaluar testin psikologjik dhe testin për integritet.

(5) Për anëtar të Komisionit Shtetëror zgjidhet personi i cili:

- është shtetas i Republikës së Maqedonisë;

- në moment të zgjedhjes me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- ka marrë së paku 300 kredi sipas SETK ose ka mbaruar shkallën VII/1 të arsimit;
- ka së paku katër vjet përvojë pune në punë administrative;
- posedon një nga certifikatat e pranuara ndërkombëtarisht ose vërtetim për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:

1. TOEFEL IBT - së paku 74 pikë,
 2. IELTS (IELTS) - së paku 6 pikë,
 3. ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal)- së paku nivelin B2 (B2),
 4. FCE (FCE) (Cambridge English: First)- të kaluar,
 5. BULATS (BULATS)- së paku 60 pikë ose
 6. APTIS (APTIS)- së paku nivelin B2 (B2) dhe
- të ketë kaluar testin psikologjik dhe testin për integritet.

(6) Zgjedhja e anëtarëve të Komisionit Shtetëror kryhet në bazë të kriterëve të profesionalitetit dhe kompetencës dhe në pajtim me parimin e përfaqësimit të drejtë dhe adekuat.

(7) Anëtarët e Komisionit Shtetëror nga radhët e tyre zgjedhin zëvendëskryetar.

(8) Kryetari dhe anëtarët e Komisionit Shtetëror nuk mund të jenë anëtarë në organe dhe trupa të cilat i zgjedh ose emëron Kuvendi i Republikës së Maqedonisë ose Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Neni 4

(1) Kryetarit ose anëtarit të Komisionit Shtetëror mandati i pushon, nëse:

- vetë e kërkon këtë,
- mbush moshën 64 vjet dhe
- vdes kryetari ose anëtar.

(2) Kryetari ose anëtari i Komisionit Shtetëror shkarkohet para kalimit të mandatit, nëse:

- në mënyrë të përhershme e humb aftësinë për kryerjen e funksionit, që e konstaton Kuvendi i Republikës së Maqedonisë,

- është dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor për vepër penale me dënim pa kusht prej së paku gjashtë muaj ose

- kryen punë të cilat janë të papajtueshme me funksionin anëtar ose kryetar i Komisionit Shtetëror.

(3) Propozim për shkarkim të kryetarit dhe anëtarit të Komisionit Shtetëror mund të parashtrijë edhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(4) Për ekzistimin e arsyeve për shkarkimin e kryetarit ose anëtarit të Komisionit Shtetëror para kalimit të mandatit, kryetari (ose zëvendëskryetari në rast të shkarkimit të kryetarit) është i obliguar që ta njoftojë Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, në afat prej 30 ditësh nga dita e kuptimit.

(5) Kuvendi i Republikë së Maqedonisë fillon procedurë për përcaktimin e propozimit për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit Shtetëror së paku tre muaj para kalimit të mandatit të tyre. Procedura për zgjedhje duhet të mbarojë së paku 30 ditë para mbarimit të rregullt të mandatit të kryetarit dhe të anëtarëve.

Neni 5

Mënyra e punës dhe vendimmarrja në Komisionin Shtetëror rregullohet me Rregullore të cilën e miraton Komisioni.

Neni 6

(1) Komisioni Shtetëror për punën e vet parashtron raport vjetor te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë deri në fund të marsit në vitin rrjedhës për vitin paraprak, për miratim.

(2) Me kërkesë të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë Komisioni Shtetëror është i obliguar që të parashtojë raport edhe për periudhë më të shkurtër se një vit.

(3) Raporti vjetor veçanërisht përmban:

- numrin e lëndëve të pranuar,
- numrin e lëndëve të zgjidhura (ankesa të hedhura poshtë, të refuzuara dhe të pranuar),
- numrin e lëndëve të pazgjidhura,
- numrin e lëndëve për të cilat është ngritur kontest administrativ (lëndë të refuzuara dhe të pranuar) dhe
- analizën statistikore të procedurave të mbrojtjes juridike.

Neni 7

Ndalohet çdo formë e ndikimit mbi miratimin e vendimeve të Komisionit Shtetëror, e në veçanti çdo keqpërdorim i autorizimeve publike, për shkak të ndikimit në rrjedhën dhe rezultatin e procedurës.

Neni 8

(1) Në procedurën për ankesë para Komisionit Shtetëror kundër vendimeve për kundërvajtje që janë miratuar nga organi kundërvajtës parashtruesi i ankesës, krahas taksës administrative, paguan dhe kompensim për mbajtjen e procedurës në varshmëri nga lartësia e gjobës së shqiptuar, si vijon:

- deri në 1 000 euro në kundërvlerë me denarë, kompensim prej 20 eurosh në kundërvlerë me denarë,
- nga 1 000 deri në 5 000 euro në kundërvlerë me denarë, kompensim prej 50 eurosh në kundërvlerë me denarë,
- nga 5 000 deri 20 000 euro në kundërvlerë me denarë, kompensim prej 100 eurosh në kundërvlerë me denarë,
- nga 20 000 deri 100 000 euro në kundërvlerë me denarë, kompensim prej 200 eurosh në kundërvlerë me denarë,
- nga 100 000 deri 200 000 euro në kundërvlerë me denarë, kompensim prej 300 eurosh në kundërvlerë me denarë ose
- mbi 200 000 euro në kundërvlerë me denarë, kompensim prej 400 eurosh në kundërvlerë me denarë

(2) Në procedurën për ankesë para Komisionit Shtetëror kundër aktvendimeve të miratuara në shkallë të parë në procedurë inspektuese, parashtruesi i ankesës paguan taksë administrative për ankesë në shumë të përcaktuar me ligj.

(3) Kompensimi dhe taksa nga paragrafi (1) i këtij neni dhe taksa nga paragrafi (2) i këtij neni janë të hyra të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

Neni 9

(1) Për lëndët e ankesës Komisioni Shtetëror vendos në mbledhje me shumicë nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

(2) Komisioni Shtetëror mund të punojë vetëm nëse në mbledhje janë prezent së paku pesë anëtarë. Në mbledhjet e Komisionit Shtetëror detyrimisht merr pjesë kryetari dhe/ose zëvendësi i tij.

(3) Anëtari i Komisionit Shtetëror nuk mund të jetë i përmbajtur gjatë votimit.

(4) Mbledhjet e Komisionit Shtetëror nuk janë publike.

(5) Për procedurën për këshillim dhe votim mbahet procesverbal i veçantë. Procesverbalin e nënshkruajnë të gjithë anëtarët prezent të Komisionit Shtetëror dhe mbajtësi i procesverbalit.

(6) Komisioni Shtetëror vendos në afat prej dy muajve nga dita e parashtrimit të ankesës.

(7) Kur Komisioni Shtetëror vepron sipas ankesës së parashtruar kundër aktvendimit i cili një herë është anuluar dhe kthyer në zgjidhjen e sërishme, duke vepruar sipas ankesës, Komisioni Shtetëror vetë do ta zgjidhë lëndën.

(8) Nëse Komisioni Shtetëror nuk miraton aktvendim në afatin nga paragrafi (6) i këtij neni, parashtruesi i ankesës mund ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror Administrativ në afat prej pesë ditësh pune.

(9) Inspektorati Shtetëror Administrativ është i obliguar që në afat prej dhjetë ditësh nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi (8) i këtij neni, të kryejë mbikëqyrje në Komisionin Shtetëror nëse është zbatuar procedura në pajtim me ligjin edhe në afat prej tri ditësh pune nga dita e mbikëqyrjes së kryer e njofton parashtruesin e ankesës.

(10) Inspektori nga Inspektorati Shtetëror Administrativ pas mbikëqyrjes së kryer në pajtim me ligjin miraton aktvendim me të cilin e detyron kryetarin dhe anëtarët e Komisionit Shtetëror që në afat prej dhjetë ditësh të vendosin për ankesën e parashtruar dhe ta njoftojë inspektoratin për aktin e miratuar. Me njoftim dorëzohet kopje nga akti me të cilin kanë vendosur për ankesën e parashtruar.

(11) Nëse kryetari dhe anëtarët e Komisionit Shtetëror nuk vendosin në afatin nga paragrafi (10) i këtij neni, inspektori do të parashtojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ kundër kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit Shtetëror dhe do të përcaktojë afat plotësues prej pesë ditësh pune, në të cilin kryetari dhe anëtarët e Komisionit Shtetëror do të vendosin për ankesën e parashtruar për çfarë në afat të njëjtë do ta njoftojnë inspektoratin për aktin e miratuar. Me njoftim dorëzohet kopje nga akti me të cilin kryetari dhe anëtarët e Komisionit Shtetëror kanë vendosur për ankesën e parashtruar. Inspektori në afat prej tri ditësh pune e informon parashtruesin e ankesës.

(12) Nëse kryetari dhe anëtarët e Komisionit Shtetëror nuk vendosin edhe në afatin plotësues nga paragrafi (11) i këtij neni, inspektori në afat prej tri ditësh pune do të parashtojë kallëzim te prokurori publik kompetent dhe në atë afat do ta njoftojë parashtruesin e ankesës.

(13) Nëse inspektori nuk vepron sipas njoftimit nga paragrafi (9) i këtij neni, parashtruesi i ankesës në afat prej pesë ditësh pune ka të drejtë të parashtojë ankesë te sekretaria e drejtorit të Inspektoratit Shtetëror Administrativ. Nëse drejtori nuk ka sekretari, ankesa parashtrohet në sekretarinë e selisë së Inspektoratit Shtetëror Administrativ.

(14) Drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ është i obliguar që në afat prej tri ditësh pune ta shqyrtojë ankesën nga paragrafi (13) i këtij neni dhe nëse konstaton se inspektori nuk ka vepruar për njoftimin nga parashtruesi i ankesës në pajtim me paragrafët (9) dhe (10) të këtij neni dhe/ose nuk parashtron kallëzim në pajtim me paragrafët (11) dhe (12) të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të parashtojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ për inspektorin, do të përcaktojë afat plotësues prej pesë ditësh pune në të cilin inspektori do të kryejë mbikëqyrje në Komisionin Shtetëror nëse është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditësh pune nga dita mbikëqyrjes së kryer e informon parashtruesin e ankesës.

(15) Nëse inspektori nuk vepron edhe në afatin plotësues nga paragrafi (14) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të parashtojë kallëzim te prokurori publik kompetent kundër inspektorit dhe në afat prej tri ditësh pune do ta njoftojë parashtruesin e ankesës.

(16) Në rastin nga paragrafi (15) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ, menjëherë e më së voni në afat prej një ditë pune, do të autorizojë inspektor tjetër që ta zbatojë mbikëqyrjen menjëherë.

(17) Në rastin nga paragrafi (16) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ në afat prej tri ditësh pune e njofton parashtruesin e ankesës.

(18) Nëse drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ nuk vepron në pajtim me paragrafin (14) të këtij neni, parashtruesi i ankesës mund të parashtrojë kallëzim te prokurori publik kompetent në afat prej tetë ditësh pune.

(19) Nëse kryetari dhe anëtarët e Komisionit Shtetëror nuk vendosin në afatin nga paragrafi (12) i këtij neni, parashtruesi i ankesës mund të ngritë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

(20) Procedura në Gjykatën Administrative është urgjente.

Neni 10

(1) Gjatë zgjidhjes së ankesave Komisioni Shtetëror mban procesverbal.

(2) Procesverbali duhet të përmbajë të dhëna të rëndësishme për veprimet e marra, respektivisht vendimet e miratuara në bazë të debatit.

(3) Procesverbalin e nënshkruan kryetari, anëtarët e pranishëm dhe mbajtësi i procesverbalit dhe është pjesë përbërëse e lëndës.

Neni 11

Kundër aktvendimit të Komisionit Shtetëror mund të ngritet kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Padia kundër aktvendimit të Komisionit Shtetëror nuk e prolongon realizimin e vendimit.

Neni 12

(1) Procedurat për ankesat kundër aktvendimeve të inspektorëve të miratuara në procedurë administrative në mbikëqyrje inspektuese para Komisionit Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë, të filluara deri në fillimin e zbatimit të këtij ligji do të mbarohen nga Komisioni Shtetëror në pajtim me dispozitat sipas të cilave janë filluar.

(2) Zgjidhja e lëndëve të filluara deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji për të cilat është ngritur kontest administrativ do të vazhdojë në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(3) Ligjet ekzistuese me të cilat është përcaktuar e drejta e ankesës kundër aktvendimeve të inspektorit në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë, do të harmonizohen me dispozitat nga ky ligj deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji.

(4) Ligjet ekzistuese me të cilët është rregulluar kompetenca e organit kundërvajtës që të vendosë në procedurë kundërvajtëse do të harmonizohen me dispozitat e këtij ligji deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji.

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të fillojë të zbatohet nga 1 shkurti 2015.